



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

Njoftim Paraprak Përqendrimi

Rasti: Përfitim Kontrolli / Messer Hungarogaz Kft.- Air Liquide Hungary Ipari Gaztermelo Kft.

Në datën 13 Tetor 2015, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Marrëveshjes mbi transferimin e kuotave” e nënshkruar midis palëve Air Liquide Eastern Europe S.A (në cilësinë e Aksionerit Shitës) dhe Messer Hungarogaz Kft.(në cilësinë e Blerësit) , më datë 15 Shtator 2015, me objekt përfitim e vetëm eskuziv të kontrollit të shoqërisë Air Liquide Hungary Ipari Gaztermelo Kft. (Targeti) nga shoqëria Messer Hungarogaz Kft., me anë të përfimit të 100% të kapitalit të Targetit nga Blerësi. Ky përqendrim është njoftuar pran Autoritetit të Konkurrencës për shkak të xhirove që realizon Grupi Messer në Shqipëri me anë të degës së tij Messer Albagaz Sh.p.k.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **Messer Hungarogaz Kft:** është një shoqëri hungareze , pjesë e grupit Messer e cila ushtron veprimtarinë në aktivitetin e furnizimit të gazeve industriale dhe mjekësorë. Grupi Messer është prezent në Shqipëri me degën e tij Messer Albagaz Sh.p.k e cila është aktive në furnizimin e gazeve industriale.
- **Air Liquide Hungary Ipari Gaztermelo Kft.:** është një shoqëri hungareze dhe është aktive në furnizimin e gazeve industriale dhe mjekësore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 10, pika 1, shkronja b), 12, pika 1) dhe 2 , pika 1) shkronja a) dhe nenit 2 të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al